

# *Kosova Anthropologica*

Revistë e Departmentit të Antropologjisë  
Fakulteti i Filozofisë, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”  
Prishtinë, Republika e Kosovës

- 1. Qëllimi**
- 2. Qasja e hapur dhe e drejta e autorit**
- 3. Deklarata etike**
- 4. Politika editoriale**
- 5. Udhëzimet për autorët**
- 6. Udhëzimet për recensentët e jashtëm**
- 7. Redaksia**
- 8. Info**

## **1. Qëllimi**

*Kosova Anthropologica* është një revistë vjetore akademike e Departamentit të Antropologjisë (Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”). Qëllimi i revistës është avancimi i njohurive dhe dijes antropologjike për Kosovën dhe rajonin. Revista shërben si forum i hapur për studiues, kryesisht të fushës së antropologjisë kulturore/sociale, arkeologjisë dhe antropologjisë gjuhësore. I drejtohet audiencës shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të interesuar në studimin antropologjik të kulturës, shoqërisë dhe realiteteve jetësore, me fokus në Kosovë dhe rajon. *Kosova Antropologjica* boton ese në të dy gjuhët, në gjuhën shqipe dhe angleze. Të gjitha esetë/shkrimet e botuara duhet të jenë të standardeve më të larta të botimit akademik në revista shkencore. *Kosova Antropologjia* është e hapur për kontributet e studiuesve të interesuar për të botuar në fushat/temat e mësipërme dhe përfshin studime të fokusuara në analizë antropologjike të orientuara nga gjetjet empirike të temave specifike, mirëpo boton edhe ese të cilat janë gjithashtu të orientuara nga reflektimet teorike dhe recensione të librave, filmave, dokumentarëve dhe mediave të tjera vizuale.

## **2. Qasja e hapur dhe e drejta e autorit**

*Kosova Antropologjia* botohet një herë në vit, në dhjetor, në formë të shtypur (në sasi të kufizuar) dhe në formë digjitale (PDF). *Kosova Anthropologica* ofron përmbajtje me QASJE TË HAPUR duke ndjekur parimin universal se dija e hapur për publikun mbështet shkëmbimin kulturor global të shkencës e dijes. *Kosova Anthropologica* nuk ka tarifa për pranimin, përpunimin apo botimin artikujve.

Sipas licencës *Creative Commons Attribution-NonCommercial-NoDerivs*, siç shfaqet aktualisht në <http://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/4.0/> autori/autorët dhe përdoruesit janë të lirë të ndajnë (kopjojnë, shpërndajnë dhe transmetojnë kontributin) në kushtet e mëposhtme: 1. ata duhet t'ia atribuojnë autorit apo licensuesit kontributin e përcaktuar, 2. ata nuk mund ta përdorin këtë kontribut për qëllime komerciale, 3. nuk mund ta ndryshojnë, transformojnë ose ndërtojnë mbi këtë punë/vepër.

Autori ruan të drejtat e mëposhtme:

- e drejta e autorit dhe të drejta të tjera pronësore në lidhje me esenë/shkrimin, të tilla si të drejtat e patentës,
- e drejta për të përdorur përmbajtjen e esesë/shkrimit në veprat e veta të ardhshme, duke përfshirë leksionet dhe librat,
- të drejtën për të riprodhuar esenë/shkrimin për qëllime vetjake, me kusht që kopjet të mos ofrohen për shitje,
- e drejta për të vetëarkivuar esenë/shkrimin.

### 3. Deklarata etike

*Kosova Antropologjia* i përmbahet udhëzimeve, rregulloreve dhe rekomandimeve etike të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe vepron sipas praktikës më të mirë redaktuese të *Komisionit mbi Etikën e Botimit* (Committee on Publication Ethics - COPE) për redaktorët e revistave shkencore.

Më poshtë është një përmbledhje e parimeve dhe standardeve etike të revistës për të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin e pranimit, redaktimit/recensionit dhe botimit të esëve/shkrimeve.

Të gjithë autorët që botojnë në *Kosova Anthropologica* duhet të ndjekin udhëzimet e EASA (European Association of Social Anthropologists - *Asociacioni Evropian i Antropologëve Socialë*) mbi etikën e kërkimit.

Autorët mbajnë përgjegjësi për origjinalitetin e shkrimit të tyre. Ata janë të detyruar të citojnë autorët, idetë dhe informacionet në mënyrë korrekte dhe sipas nevojës, duke iu përmbajtur një sistemi referimi (Manuali i Çikagos/Chicago Manual of Style, edicioni 17) i përdorur nga *Kosova Anthropologica*. Në çdo rast gabimi ose pasaktësie në shkrimin e botuar, redaktorët duhet të informohen menjëherë.

Autorët duhet të përdorin softuer antiplagjiaturë për të verifikuar nëse shkrimet e tyre përmbajnë elemente të plagjiaturës së mundshme, përpara se ta dërgojnë shkrimin e tyre në revistë për botim përfundimtar. Ata duhet të ndjekin praktikat më të mira dhe të marrin masa për të siguruar se nuk evidentohet plagjiaturë në punimin e tyre. Pra, të gjitha çështjet e plagjiaturës në shkrimin e tyre janë përgjegjësi vetëm e autorit. Në rast të evidentimit të plagjiaturës dhe pas shqyrtimit të duhur, *Kosova Anthropologica* ruan të drejtën ta tërheqë punimin e botuar dhe ta informojë publikun për të.

Autorët mund të dorëzojnë dorëshkrimin e tyre në gjuhën shqipe dhe/ose në gjuhën angleze. Autorët duhet të dërgojnë edhe një rezymë narrative të biografisë së shkurtër (deri në 150 fjalë), duke përfshirë statusin profesional, së bashku me shkrimin/esenë e tyre.

Autorët nuk mund të dërgojnë për botim shkrime të botuara diku tjetër. Përkthimet e esëve veçse të botuara gjetiu në gjuhën angleze dhe gjuhë të tjera të huaja, mund të botohen nga *Kosova Anthropologica*, në raste të veçanta dhe kur kërkohen dhe miratohen nga redaktorët, me leje të autorit dhe/ose botuesit paraprak.

Autorët detyrohen që vetë të marrin leje nga çdo mbajtës i së drejtës së autorit për të botuar fotografi, ilustrime, tabela dhe materiale të tjera të ngjashme të mbrojtura nga ligjet për të drejtat e autorit. Materiali me të drejtë të autorit mund të riprodhohet vetëm me lejen e duhur faktike. Autorët janë përgjegjës të marrin të drejtën për materialin e përdorur dhe ata do të nënshkruajnë një marrëveshje me *Kosova Anthropologica* duke deklaruar këtë përgjegjësi.

Autorë të esesë/recensionit janë ata që kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në artikull. Autori korrespondent është i obliguar që të kreditojë të gjithë autorët që kanë kontribuar në hartimin e shkrimit/esesë të dërguar dhe të gjithë autorët duhet ta miratojnë draftin përfundimtar të shkrimit dhe të pajtohen paraprakisht që ta dërgojnë te revista *Kosova Anthropologica*.

Nga autorët pritet që t'u përgjigjen me kohë komenteve dhe sugjerimeve të redaksisë dhe recensentëve. Autorët duhet ta kthejnë përgjigjen e tyre në mënyrë profesionale. Në rast tërheqjeje nga procesi i recensionit dhe para se shkrimi të botohet nga revista, autorët janë të detyruar ta informojnë kryeredaktorin e revistës. Një sjellje e ngjashme pritet në rast gabimesh, lëshimesh dhe pasaktësish. Të gjitha komunikimet dhe sjelljet duhet të trajtohen në mënyrë profesionale dhe sipas standardeve më të larta të etikës.

Në rast të një gabimi/shkeljeje të rëndë, shkrimi/eseja e kontestuar do të tërhiqet nga revista dhe do të bëhet një njoftim në numrin vijues të revistës.

#### 4. Politika editoriale

Recensionin e shkrimit që bëhet nga kolegët e jashtëm, anonimë për autorin dhe në mënyrë anonime nga recensentët për autorin, është vlerësimi i pavarur i hulumtimit / shkrimit nga ata që janë ekspertë të fushës.

Recensionin e kolegëve vlerëson cilësinë e punimit. Recensionin e kolegëve avancojnë nivelin e hulumtimit të realizuar nga komuniteti akademik. Kolegët recensentë janë anëtarë të komunitetit akademik që punojnë për komunitetin akademik. Mbi të gjitha, recensionin si akt shqyrtimi e vlerësimi është një mekanizëm i kontrollit të cilësisë dhe një mekanizëm komentimi/konverzacioni për autorët, në ruajtjen dhe ngritjen të standardeve akademike.

Kryeredaktori dhe redaktorët, përfshirë asistentët e redaksisë, nuk mund të botojnë punën/shkrimet e tyre në revistë. Ata mund të botojnë vetëm shkrim editorial/hyrje për edicion specifik të revistës.

Stafi akademik i Departamentit të Antropologjisë nuk mund të jenë recensentë të revistës, por ata mund të dërgojnë shkrimet/ esetë e tyre për botim në revistë. Po ashtu, edhe stafi tjetër i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", mund të dërgojnë shkrime/ese për botim, po qe se i përmbahen rregullave dhe në studimet e shkrimet e tyre përdorin një qasje teorike antropologjike dhe të orientuar nga evidenca empirike.

Redaktorët dhe recensentët e jashtëm nuk marrin parasysh: moshën, gjininë, orientimin seksual, fenë, kombësinë, statusin shkencor, shtetësinë, bindjet politike të autorëve gjatë pranimit, recensionit dhe vendimmarrjes editoriale për pranimin e punimit për botim.

Puna e brendshme redaktoriale dhe recensuese nga kolegët e jashtëm kryhet si vijon:

1. Në fazën e parë (para votimit), kryeredaktori vlerëson dorëshkrimin e pranuar (brenda 2 javësh) dhe vendos nëse shkrimi/eseja i plotëson standardet dhe kërkesat e revistës. Nëse shkrimi/eseja nuk i plotëson standardet, kryeredaktori e refuzon atë. Nëse shkrimi/eseja i plotëson standardet, ai e dërgon atë për vlerësim të redaktorët apo anëtarët e redaksisë.

2. Në fazën e dytë (*votimi*), anëtarët e redaksisë së *Kosova Antropologica* e vlerësojnë dorëshkrimin e pranuar (në afat deri në 1 muaj pas pranimit). Anëtarët e redaksisë japin komente koncize për cilësinë e dorëshkrimit dhe vlerësojnë përputhshmërinë

e shkrimit me udhëzimet e revistës dhe synimet e qëllimet e përgjithshme. Vendimi përfundimtar merret me shumicë votash pozitive (vetëm nga redaksia, e cila përbëhet nga një numër tek redaktorësh, ndërsa kryeredaktori nuk voton). Në rast të numrit të pamjaftueshëm të votave pozitive, dorëshkrimi nuk dorëzohet për recension të jashtëm, por i kthehet autorit për përmirësim.

3. Në fazën e tretë, pasi miratohet nga anëtarët e redaksisë, dorëshkrimi kalon në procesin e recensionit të jashtëm. Redaktorët sugjerojnë recensentët e jashtëm. Kur sugjerohen recensentë të jashtëm duhet të merren parasysh këto gjëra: formimi shkencor, profili i fushës së studimit, profili i mësimdhënies (i njëjtë ose më i lartë se autori) dhe njohja e gjuhës së dorëshkrimit.

Dorëshkrimi i nënshtrohet të paktën dy recensioneve të jashtëm (*double blind peer-review*) para së të pranohet nga anëtarët e redaksisë për botim. Recensionit i jashtëm mund të kalojë deri në 5 recensentë, nëse është e nevojshme dhe në rastet kur shkrimi/eseja merr vlerësime kundërtë. Komentet e recensentëve dhe emri/identiteti i recensentëve ruhen si të dhëna konfidenciale gjatë gjithë procesit. Autori merr komentet pa emër të recensentit dhe recensenti nuk duhet identifikojë autorin apo recensentët e tjerë të së njëjtin dorëshkrim.

Kështu, dorëshkrimi i autorit pa emrin e tij/saj dhe formulari i recensionit u dërgohen recensuesve të përzgjedhur. Kjo bëhet nga asistentja e redaksisë ose/ dhe kryeredaktori, nëse është e nevojshme, në emër të redaksisë së revistës. Recensentët duhet të informohen se shkrimi/eseja e ka kaluar procesin e redaktimit të brendshëm dhe ka nevojë për vëmendjen dhe vlerësimin e kolegëve të specializuar të fushës. Recensentët kanë kohë deri në 2 muaj për të vlerësuar dorëshkrimet dhe për të dhënë komente.

Nëse recensenti nuk është në gjendje të vlerësojë dorëshkrimin në kohë ose nuk e bën këtë për ndonjë arsye tjetër, redaksia sugjeron një recensues tjetër.

*Kosova Antropologjia* boton:

- *shkrime/ese shkencore origjinale* (6000-8000 fjalë) që përmbajnë kërkime origjinale të pabotuara më parë\*
- *editoriale* (hyrje deri në 3000 fjalë)
- *recensione* (origjinale, koncize dhe kritike të librave, filmave, dokumentarëve dhe formave të tjera mediale që ndërlidhen me antropologjinë – prej 100 deri në 2500 fjalë)

---

\* Revista mund të botojë përkthime të shkrimeve në gjuhën shqipe, të cilat kërkohen dhe miratohen nga redaksia dhe me leje të autorit apo/dhe botuesit paraprak

4. Në fazën e katërt, komentet e unifikuara të redaksisë dhe recensentëve (të përpiluara nga komentet dhe sugjerimet e recensentëve dhe ato të anëtarëve të redaksisë) i dërgohen autorit, duke i kërkuar që ta korrigjojë dorëshkrimin sipas komenteve të recensentëve dhe ta dërgojë prapë dorëshkrimin e korrigjuar te anëtarët e redaksisë brenda afatit kohor prej 21 ditësh, përmes procesit të komunikimit formal me asistenten e redaksisë. Nëse autorët nuk pranojnë komentet dhe sugjerimet e recensentëve dhe anëtarëve të redaksisë, ose nëse ata nuk japin një përgjigje të hollësishme dhe adekuate për komentet mbi shkrimin/ esenë e tyre, shkrimi/ eseja refuzohet. Nëse kryeredaktori dhe/ ose anëtarët e redaksisë konsiderojnë se autori ka argumente të forta, në kundërshtim me opinionet e recensentëve, ai/ ata kërkojnë mendimin e një recensenti të tretë (ose të katërt, apo edhe të pestë).

Pas marrjes së dorëshkrimit të përmirësuar nga autori, ku merren parasysh dhe reflektohen komentet nga procesi i recensionit të recensentëve të jashtëm, anëtarët e redaksisë marrin vendim përfundimtar, me votë, për miratimin ose refuzimin të punimit.

5. Faza e pestë i referohet përkthimit të dorëshkrimit (gjuhë shqipe – gjuhë angleze, gjuhë angleze – gjuhë shqipe), varësisht se në cilën gjuhë është dërguar dorëshkrimi. Dorëshkrimet pranohen në mënyrë të barabartë në të dyja gjuhët. Nëse vërehen gabime ose mospërputhje gjatë përkthimit, përkthyesi bën komente specifike mbi dorëshkrimin dhe përkthimin e tij, dhe me pëlqimin e kryeredaktorit dhe në komunikim me të, ia dërgon autorit dhe komunikon me të direkt. Të gjitha modifikimet në dorëshkrim duhet të shënohen me "*track changes*" në formatin WORD. Emri i përkthyesit duhet të shënohet si përkthyes i shkrimit relevant.

6. Në fazën e gjashtë, pas aprovimit final, dorëshkrimi shkon në lekturë. Lektura zgjat deri në 21 ditë. Pas lekturës, dorëshkrimi i lekturuar i kthehet autorit me kërkesë për pranimin, korrigjimin apo refuzimin e lekturës, brenda 5 ditëve.

7. Faza e shtatë dhe e fundit i referohet përgatitjes së esesë së lekturuar (në të dyja gjuhët) për botim përmes shtypit (shtyp në letër/dixhital). Versioni dixhital i shkrimit/ esesë u dërgohet anëtarëve të redaksisë për kontrollin përfundimtar. Në rast të ndonjë korrigjimi, anëtarët e redaksisë i dërgojnë komentet dhe korrigjimet e tyre te kryeredaktori, i cili bën kontrollin përfundimtar të cilësisë për të korrigjuar çdo gabim të kryer gjatë përkthimit dhe/ose të vërejtur nga redaktorët. Eseja përfundimtare, në të dy gjuhët, së bashku me Marrvëshjen për Botim me Qasje të Hapur, i dërgohet autorit për aprovim dhe nënshkrim. Pas marrjes së aprovimit dhe nënshkrimit, kryeredaktori përgatit versionin përfundimtar të revistës për botim. Për çdo koment të publikimit të postimit, lexuesit ftohen të kontaktojnë kryeredaktorin me email.

Redaktorët, autorët dhe recensentët duhet të jenë të vetëdijshëm se procesi i recensionit nga kolegët është proces konfidencial, që synon të kontrollojë cilësinë dhe të ndihmojë autorët dhe revistat të përmirësojnë cilësinë e kërkimit dhe shkrimet akademik.

## 5. Udhëzimet për autorët

Autorët duhet të lexojnë listën e udhëzimeve që duhet të kenë parasysh para se të dërgojnë shkrimet/ esetë e tyre në adresë të redaksisë. Dorëshkrimet që nuk i përmbahen këtyre udhëzimeve do t'u kthehen autorëve.

*Lista udhëzuese për përgatitjen e dorëshkrimit*

- Të gjitha propozimet duhet të dorëzohen në [kosova.anthropologica@uni-pr.edu](mailto:kosova.anthropologica@uni-pr.edu) and/or [kosovaanthropologica@gmail.com](mailto:kosovaanthropologica@gmail.com)
- Shkrimet e botuara dhe ato të dërguara në ndonjë revistë tjetër nuk duhet të dërgohen te revista *Kosova Anthropologica*
- Dorëshkrimi duhet të dërgohet në formatin WORD
- Fonti duhet të jetë me 1,5 hapësirë mes rreshtash, i madhësisë 12, ndërsa të gjitha ilustrimet, figurat, tabelat duhet të vendosen brenda tekstit (fotografitë dhe ilustrimet e tjera duhet të bashkëngjiten gjithashtu si të veçanta në formatin JPEG, të emërtuar siç duhet dhe me rezolucion të lartë)
- Dorëshkrimi duhet t'u përmbahet udhëzimeve të përshkruara më poshtë:

*Udhëzimet për dorëshkrimin e autorit*

- Dorëshkrimet mund të ndryshojnë në gjatësi; shkrimet shkencore origjinale nuk duhet të kalojnë 8000 fjalë, në përgjithësi, duke përfshirë bibliografinë dhe shënimet, dhe nuk duhet të jenë më të shkurtra se 6000 fjalë, duke përfshirë bibliografinë dhe shënimet. Recensionet e librave, filmave, dokumentarëve dhe mediave të tjera duhet të jenë brenda kufirit 1000 -1500 fjalë. Editorialet kufizohen deri në 3000 fjalë;
- Dorëshkrimet mund të dërgohen në gjuhën shqipe ose në gjuhën angleze te [kosova.anthropologica@uni-pr.edu](mailto:kosova.anthropologica@uni-pr.edu) dhe / ose [kosovaanthropologica@gmail.com](mailto:kosovaanthropologica@gmail.com) në formatin WORD. Tabelat, figurat, ilustrimet dhe dhe fotot duhet të përfshihen në tekstin kryesor (për të identifikuar vendin e tyre në tekst) dhe si fajlle të veçanta në formatin JPEG, me rezolucion të lartë [të paktën 150];
- Dorëshkrimet shkencore do të lexohen dhe vlerësohen nga anëtarët e redaksisë dhe recensentët e jashtëm, e këta të fundit do të bëjnë vlerësimin përmes një anonimiteti reciprok (autor-recensent) të redaktimit të dorëshkrimit;

- Çdo dorëshkrim duhet të përfshijë një abstrakt prej maksimumi 150-200 fjalësh, duke përmbledhur argumentet kryesore të artikullit, plus 5 fjalë kyçe. Faqja e parë duhet të përmbajë emrin, statusin profesional dhe adresën zyrtare të secilit autor;
- Autorët duhet të sigurohen që të gjitha tabelat, figurat, shënimet, etj., të jenë të numëruara në mënyrë të njëpasnjëshme pa asnjë boshllëk;
- Autorët duhet të kontrollojnë referencat në mënyrë sistematike për t'u siguruar që të gjitha veprat e cituara në tekst janë renditur gjithashtu në seksionin e bibliografisë dhe anasjelltas, sipas *Manualit të Stilit të Çikagos, edicioni 17*. Dorëshkrimet që nuk përfillin sistemin e saktë të referimit dhe bibliografisë do të refuzohen menjëherë nga kryeredaktori, në fazën e parë;
- Pas pranimit, të gjitha dorëshkrimet (apo përkthimet) në gjuhën shqipe do të korrigjohen nga një lektor profesionist i gjuhës shqipe;
- Pas pranimit, të gjitha dorëshkrimet (apo përkthimet) në gjuhën angleze do të korrigjohen nga një lektor profesionist i gjuhës angleze;
- Pas miratimit, përkthimit dhe korrigjimit, autorët do të nënshkruajnë marrëveshjen e botimit. Pas nënshkrimit të marrëveshjes së botimit, dorëshkrimet nuk mund të tërhiqen;
- Pas pranimit dhe nënshkrimit të marrëveshjeve, të gjitha dorëshkrimet do të botohen në të dyja gjuhët njëkohësisht;

#### *Referencat, Citimet dhe Bibliografia*

Autorët duhet të përdorin *Manualin e Çikagos* [*Chicago Manual of Style – Author – Date System*] (botimi i 17-të) si sistem reference kur dërgjnë shkrime të *Kosova Anthropologica*. Gjithashtu, ata duhet të përdorin fundnotat për shpjegime të mëtejshme.

Një udhëzim i shkurtër për stilin Author-Date:

#### **Libri**

Bibliografia:

Connerton, Paul. 1989. *How Societies Remember*. Cambridge: Cambridge University Press.

Në tekst:



(Connerton 1989, 23)

### **Kapitull libri**

Bibliografia:

Cruz-Torres, M.L, dhe Pamela McElwee. 2017. "Gender, Livelihoods, and Sustainability: Anthropological Research" Routledge Handbook of Gender and Environment, ed. Sherilyn MacGregor (133 - 145), London, New York: Routledge.

Në tekst:

(Cruz-Torres and McElwee 2017, 133)

### **Ese / shkrim në revista shkencore:**

Bibliografia:

Laviolette, P. and Tatiana Argounova-Low. 2021. "Introduction:Auto-anthropocenes" Social Anthropology, 29 (4): 1008-1017.

Në tekst:

(Laviolette and Argounowa-Low 2020, 477)

### **Intervistë e pabotuar etnografike:**

Fundnota:

1. Hasan Hyseni, (mësues, shkolla fillore "Elena Gjika" në Prishtinë), intervistë gjysmë e strukturuar, 17 shtator 2021

### **Për më shumë shih:**

<https://www.chicagomanualofstyle.org/home.html>

Nëse keni nevojë për sqarime mbi referencat, bibliografinë dhe *Manualin e Çikagos*, kërkoni udhëzime duke kontaktuar kryeredaktorin: [arsim.canolli@uni-pr.edu](mailto:arsim.canolli@uni-pr.edu) ose asistenten e redaksisë: [rozafa.berisha@uni-pr.edu](mailto:rozafa.berisha@uni-pr.edu)

## **6. Udhëzime për recensentët e jashtëm**

Procesi i recensionit të jashtëm nga kolegët bëhet sipas anonimitetit reciprok (recensues-autor) të vlerësimit e redaktimit.

Recensentët e jashtëm janë ekspertë dhe konsulentë të jashtëm akademik për revistën. Recensenti kontribuon në avancimin e cilësisë së punimit të caktuar në veçanti dhe dijes objektive në përgjithësi.

Në thelb, recensentët e jashtëm vlerësojnë punimin dhe sugjerojnë nëse një punim duhet të botohet apo jo, ndërsa kryeredaktori dhe anëtarët e redaksisë marrin vendimin përfundimtar, bazuar në sugjerimet e recensentëve.

Para se të pranojë të vlerësoj dorëshkrimin, recensenti duhet të shohë nëse punimi është në fushën e tij/saj të ekspertizës dhe, nëse vëren, duhet të deklarojë çdo konflikt interesi në lidhje me dorëshkrimet e dorëzuara.

Kur jep komentet për redaksinë, recensenti mund të kërkojë që të lexojë për herë të dytë dorëshkrimi e përmirësuar nga autori dhe mund të japë komente të mëtejshme për redaktorët.

Recensentët duhet të japin komente konstruktive, gjithëpërfshirëse, të bazuara dhe substanciale në raportin e tyre.

Recensentët duhet t'i tërheqin vëmendjen redaktorëve nëse vërejnë ndonjë ngjashmëri të konsiderueshme midis dorëshkrimit në vlerësim dhe çdo punimi të botuar ose dorëshkrimi të dorëzuar për botim diku tjetër, për të cilin ata janë në dijeni.

Rishikuesi i paraqet komentet e tij/saj përmes formularit të recensionit të dërguar nga revista.

Recensentit i dërgohet udhëzuesi që shpjegon qëllimet e revistës dhe u shpejgohet se përse ata janë zgjedhur për të shqyrtuar një dorëshkrim të caktuar për botim.

Recensentët japin këshilla në dy aspekte kryesore:

1. Originaliteti, argumentet dhe prezantimi i përgjithshëm i dorëshkrimit para lexuesve të revistës;
2. Saktësia e metodologjisë;

Recensentët japin komente të hollësishme, duke kërkuar sqarime, duke bërë sugjerime dhe duke kërkuar shtjellime të mëtejshme kur është e nevojshme.

Recensentët zakonisht rekomandojnë ta pranojnë dorëshkrimin për botim, t'i bëhen përmirësime të vogla dorëshkrimit para se të botohet, t'i bëhen përmirësime substanciale dorëshkrimit para se të konsiderohet për botim ose ta refuzojnë dorëshkrimin.

Të gjithë recensentët i përmbahen praktikave më të mira të recensionit të ofruara nga udhëzimet etike të *Komisionit mbi Etikën e Botimit* (Committee on Publication Ethics - COPE) për recesentët.

## 7. Redaksia

### Kryeredaktori

**Prof. Asoc. Dr. Arsim Canolli** ligjëron antropologjinë kulturore në Departamentin e Antropologjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Kosovë. Ka përfunduar doktoratën në antropologjinë sociale në UCL/Londër (2014), me fokus në kulturën materiale në përgjithësi dhe në kulturën buknore në veçanti. Ka shkruar disa libra dhe punime me tema të kulturës së bukës/ushqimit, teorive antropologjike, historisë së etnologjisë kosovare, trashëgimisë kulturore, muzeve etnografike, historisë gojore dhe festivaleve folklorike. Libri i tij i fundit është "*Rrënjë, rrugëtime, rropatje: interpretime antropologjike*" (2022). Ka mbikëqyrur disa projekte për kujtesën kolektive, duke përfshirë "Kujtesa e Trepçës: rrëfimet e 100 minatorëve të Trepçës" (2023), "Kujtesa e Kosovës: rrëfime të 100 pleqve e plakave" (2017-2020).

### Asistentja e redaksisë

**Dr. Rozafa Berisha** është antropologe sociale. Studimet bachelor i ka përfunduar në Universitetin e Prishtinës ndërsa ato master në KU Leuven. Në vitin 2022, ajo ka përfunduar studimet e doktoratës në antropologji sociale në Universitetin e Manchesterit. Teza e saj ka hulumtuar shpresat dhe praktikën e orientuara drejt së ardhmes të grave të reja një dekadë pas pavarësisë së Kosovës, duke shpallur se si projekti politik i shtet-ndërtimit, ashtu si edhe gjinia e klasa, formëson këto shpresa si në nivel kolektiv ashtu edhe në atë individual. Ky projekt është vlerësuar me çmimin Radcliffe-Brown në Angli. Hulumtimi i saj i mëparshëm është botuar në *Anthropology of East Europe Review* dhe ajo gjithashtu është autore në kapituj librash dhe blog poste antropologjike. Ajo ka ligjëruar në Universitetin e Mançesterit dhe aktualisht jep mësim në Departamentin e Antropologjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina".

### Anëtarët e redaksisë

**Prof. Dr. Michael Galaty** (PhD në Antropologji, 1998; Universiteti i Wisconsinit) është profesor i antropologjisë në Departamentin e Antropologjisë, Drejtor dhe Kurator i Arkeologjisë Evropiane në Muzeun e Arkeologjisë Antropologjike në Universitetin e Miçiganit. Puna e tij në terren është në Shqipëri, Greqi dhe Kosovë, me fokus në origjinën parahistorike të pabarazive sociale. Për këtë qëllim, ai përdor studime intensive rajonale dhe gërmime specifike, së bashku me teknika të ndryshme laboratorike, për të gjurmuar ndryshimin e faktorëve ekonomikë dhe

politikë që çojnë në ndryshime transformuese në sistemet shoqërore mesdhetare dhe ballkanike, në veçanti gjatë epokës së bronzit.

**Prof. Ass. Dr. Christophe J. Goddard** (CNRS) është drejtor i Institutit Kërkimor CNRS ('Arkeologjia dhe Filologjia e Lindjes dhe Perëndimit' - AOROC) në Ecole Normale Supérieure dhe Ecole Pratique des Hautes Etudes (PSL) në Paris. Ka qenë bashkëpunëtor i Ecole française de Rome. Ai ka kryer doktoraturën në Université of Nanterre-Paris 10 me një disertacion mbi evolucionin e devotshmërisë pagane në Italinë e Antikitetit të Vonë. Si arkeolog, ka kryer gërmime në Romë në Janiculum dhe tani është drejton misionin arkeologjik franko-kosvar dhe evropian në Ulpianë (Kosovë) bashkë me Arben Hajdarin dhe Milot Berishën. Ai është autori i librit të ardhshëm *Crépuscule des temples dans l'Antiquité tardive*.

**Prof. Dr. Nebi Bardhoshi** është Drejtor i Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit në Tiranë dhe bashkëpunëtor kërkimor në Shkollën Postdiplomike në Regensburg. Ka botuar monografitë "Gurtë e Kufinit: kanuni, pronësia, strukturimi social" në vitin 2011, "Antropologji e Kanunit", në 2015 dhe 2016 dhe "Etnografi në Diktaturë: Dija, Shteti dhe "Holokausti Ynë" (bashkautor me Olsi Lelajn), 2018. Interesi kërkimor i Bardhoshit është në antropologji të së drejtës si dhe shtetësisë dhe historisë së teorisë së antropologjisë sociale.

**Prof. Ass. Dr. Tahir Latifi** është udhëheqës i Departamentit të Antropologjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina". Studimet e doktoratës i kreu në Universitetin e Gracit, Qendra për Histori dhe Antropologji të Evropës Juglindore. Fokusi i tij kërkimor është mbi familjen dhe farefisninë, gjininë, politikat sociale, migrimin, demografinë dhe ndryshimet socio-kulturore. Kohët e fundit ai punon në dy projekte: "Kujtesa e Kosovës: Rrëfimet e mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe" dhe HERAS+: "Demografia historike në Kosovë", në bashkëpunim me Universitetin e Gracit, ku qëllim i projektit është identifikimi i burimeve ekzistuese për kërkimin historik demografik deri në Luftën e Dytë Botërore.

**Prof. Ass. Dr. Arben Hajdari** jep mësim në Departamentin e Antropologjisë dhe Departamentin e Historisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina". Studimet e doktoratës i kreu në Universitetin Pierre Mendès France 2, Francë. Ai ka shkruar disa punime për Municipium Ulpiana, romanizimin në Dardani, figurat fetare në antikitet, kalanë e Harilaqit dhe Kastercit etj. Ka kryer një numër projektesh të gërmimeve arkeologjike në Kosovë dhe Shqipëri. Vendi aktual i gërmimeve të tij është Parku Arkeologjik "Ulpiana", një projekt i drejtuar nga Ecole Normale Supérieure, Instituti i Arkeologjisë së Kosovës dhe Universiteti i Prishtinës, i financuar nga Bashkimi Evropian. Ai aktualisht është Kryetar i Bordit të Anëtarëve të Muzeut Kombëtar të Kosovës.

**8. Për më shumë informata:**

Prof. Asoc. Dr. Arsim Canolli  
Departamenti i Antropologjisë  
Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"  
Zyra nr. 121, Kati 1, Rr. "Nëna Terezë", p.n.  
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Email: [arsim.canolli@uni-pr.edu](mailto:arsim.canolli@uni-pr.edu)

Dr. Rozafa Berisha, asistente e redaksisë  
[Rozafa.berisha@uni-pr.edu](mailto:Rozafa.berisha@uni-pr.edu)

Website: <https://filozofiku.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,66>

*Versioni i fundit: 31 mars 2023*